SHP TETOVË

## Ndihmë humanitare për pensionistët

Shoqata e pensionistëve Tetovë, duke patur parasysh situatën e re ekonomike të shkaktuar nga Korona virusi, plotësoi nevojat e familjeve të pensionistëve që janë më të prekur nga kriza ekonomike.

Bëhet fjalë për 173 familje të pensionistëve nga kategoria e shfrytëzuesve të pensionit deri në 12,500 denarë, pa të ardhura të tjera në familje, familjarë të sëmurë rëndë që shkakton rritjen e shpenzimeve dhe kritere tjera të cilat janë të përfshira me Vendimit e Këshillit Ekzekutiv për ndarjen e ndihmës njëherëshe në të holla. Me këtë aktivitet u përfshinë të gjitha 22 degët.

Përveç kësaj kategorie pensionistësh, ndihma financiare ju dha edhe anëtarëve të organeve dhe trupave të Shoqatës, të cilët janë trajtuar dhe i janë nënshtruar Covid 19.

Në 166 familje u dha ndihmë financiare prej 3,000 denarë për familje dhe në shtatë familje u dha nga 5,000 denarë, të cilat përveç pensionit të ulët kishin edhe arsye tjera plotësuese që e kanë përkeqësuar gjendjen e tyre.

Ky aktivitet u realizua nga Shoqata e pensionistëve Tetovë me ndihmën e drejtpërdrejtë të kryetarëve të degëve, të cilët e njohin dhe e përcjellin plotësisht gjendjen e anëtarëve nëpër degë nga të gjitha aspektet që shkaktohen si rezultat i Korona virusit.

Ky aktivitet i Shoqatës është në përputhje me programin vjetor të Shoqatës dhe planin financiar për vitin 2021 dhe shpalljen e vitit 2021, si vit i aktiviteteve humanitare.

Ekziston një mundësi dhe pajtim i Këshillit ekzekutiv, nëse kjo situatë vazhdon, një pjesë e fondeve të cilat me planin financiar janë dedikuar për zbatimin e aktiviteteve në fusha të tjera, të tilla si aktivitete në fushën e argëtimit kulturor, sportit, ekskursione brenda dhe jashtë vendit, të dedikohen për ndihmë të mëtutjeshme të pensionistëve duke dhënë vauçerë për blerjen e artikujve ushqimorë ose drejtpërdrejt duke dhënë pako solidariteti.

Ekziston një mundësi përmes partnerëve tanë të biznesit, organizatave të tjera humanitare dhe Kryqit të Kuq Komunal të Tetovës, të sigurohet një lloj tjetër të ndihmës humanitare për pensionistët.

Angazhimi i Këshillit ekzekutiv dhe udhëheqësisë së Shoqatës, me qëllim që të ndihmohen pensionistët me të ardhura të ulëta pensioni, u ndesh me mbështetje të gjerë nga pjesa tjetër e anëtarëve, si dhe nga publiku i gjerë në qytet dhe qendrat rurale komunale në rajonin e Pollogut. *Svetozar Dimovski*

KRYEMINISTRI ZAEV DHE MINISTRJA SHAHPASKA TAKOJNË PENSIONISTËT

# PENSIONISTËT JANË SEGMENT I RËNDËSISHËM I SHOQËRISË SONË

Stanka Trajkova mirëpriti qëndrimin pozitiv të Qeverisë ndaj kategorisë më të vjetër të qytetarëve, në aspektin e pagesës së rregullt dhe të parakohshme të pensioneve

Kryeministri Zoran Zaev, ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Jagoda Shahpaska dhe Milan Zivkovic, Këshilltar i Kryeministrit për punë dhe politikë sociale, u takuan me kryetaren e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Stanka Trajkova, e shoqëruar nga nënkryetari dhe sekretari Këshillit ekzekutiv, Mentor Qoku dhe Menka Temellkovska. Në takim u diskutua për situatën aktuale dhe perspektivat e pensionistëve dhe të moshuarve, si një grup shumë i rëndësishëm i qytetarëve në shoqëri, dhe u theksua se Qeveria merr një qasje serioze për të tejkaluar sa më mirë sfidat aktuale që janë paraqitur në krizën ekonomiko-shoqërore të shkaktuar nga pandemia me koronavirusin KOVID-19.

Kryetarja e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Stanka Trajkova mirëpriti qëndrimin pozitiv të Qeverisë ndaj kategorisë më të vjetër të qytetarëve, në aspektin e pagesës së rregullt dhe të parakohshme të pensioneve, e cila bëhet në ditë të caktuara për të mbrojtur shëndetin e tyre, dhe përfshirjen e disa prej pensionistëve me pakon e 4-të të masave dhe ndihmën që iu dha pensionistëve me pensione deri në 15,000 denarë, si dhe kujdesin për vaksinimin në kohë kundër KOVID-19 sipas grupmoshave.

"Pensionistët janë kategoria jonë prioritare e qytetarëve në kujdesin dhe ne ndërmarrim masa dhe reforma që kanë të bëjnë me përmirësimin e standardit të tyre të jetesës, zhvillimin e shërbimeve të veçanta sociale dhe stabilizimin e sistemit të pensioneve. Pensionistët janë një segment i rëndësishëm në shoqërinë tonë, ne kujdesemi për harmonizimin e pensioneve dhe përmirësimin e shërbimeve sociale", tha kryeministri Zoran Zaev, duke shtuar se ai është i hapur për bashkëpunim dhe promovim dhe dinamizëm të të gjitha masave që do të ndihmojnë një jetë më të mirë për pensionistët, numri i të cilëve në vendin tonë është 327,000.

Në takim, ministrja Shahpaska informoi në lidhje me aktivitetet konkrete të ndërmarra me qëllim të përmirësimit të shërbimeve sociale për mbrojtjen dhe ndihmën për pensionistët, për të cilat, siç nënvizoi ajo, ekziston një bashkëpunim solid me vetëqeverisjet lokale në vend.

Në takim, u shpreh gatishmëri për bashkëpunimin e Qeverisë me LSHPM për të vazhduar në drejtim të dinamizimit të aktiviteteve sistematike, duke ruajtur trendin e rritjes së pensionit mesatar, shëndetit cilësor dhe kujdesit shoqëror për këtë kategori të qytetarëve në mënyrë që të sigurohet jetë cilësore dhe me dinjitet. Në takim u konkludua se bashkëpunimi vazhdon në drejtim të forcimit të plotë të pavarësisë dhe qëndrueshmërisë së Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. *Menka Temellkovska*

SHP KUMANOVË

## Donacion të mbulesave të shtratit për Kovid qendrën në Kumanovë

Shoqata e pensionistëve nga Kumanova vazhdon me aksionet humanitare duke organizuar donacione, kështu që në atë kontekst donacioni i fundit i cili përbëhej nga një sasi e caktuar e mbulesave të shtratit, kësaj radhe ishte dedikuar për Kovid qendrën që ndodhet në Spitalin e përgjithshëm në Kumanovë.

Me vetë donacionin thellohet edhe më tej bashkëpunimi midis Shoqatës së pensionistëve dhe pushtetit lokal dhe qendrore në vend, e gjithë kjo me qëllim që të sigurohen dhe të krijohen kushte më të mira për një jetë më dinjitoze të pensionistëve edhe kur rrezikohet shëndeti i tyre.

Për donacionin e pranuar, drejtoresha e spitalit d-r Snezhana Zaharieva në emër të Spitalit të përgjithshëm në Kumanovë shprehu falënderime, e cila në këtë rast theksoi që kjo ndihmë nga Shoqata e pensionistëve në këtë gjendje të rëndë me ballafaqimin me pandeminë është e mirëseardhur dhe ka peshë të madhe, sepse ky gjest në këtë gjendje të rëndë tregon se njerëzimi ende ekziston gjë që nga ana tjetër jep shpresë për forcimin e besimit të qytetarëve si në institucionet, ashtu edhe në vetë vendin. *T. Dimitrievski*

## A mjafton vetëm një dozë nga vaksina kundër Kovid -19

Ekzistojnë shembuj njerëzish nga gjithë bota të cilët kanë marrë një dozë të vaksinës dhe nuk vijnë më në rivaksinim. Kjo mbart me vete rrezik të madh, paralajmërojnë ekspertët. Një dozë, ndoshta është e mjaftueshme vetëm për ata të cilët kanë kaluar Kovid-19.

Rreth pesë milion Amerikanë nuk janë paraqitur që ta pranojnë dozën e dytë, pasi ishin vaksinuar me dozën e parë të vaksinës Biontek/Fajzer ose Moderna, tregojnë të dhënat të cilat i ka shpallur "Njujork tajmc".Ato janë rreth 8 për qind nga të vaksinuarit. Arsyet mund të jenë nga më të ndryshmet, duke filluar nga ajo që njerëzit nuk kanë pasur kohë ose nuk kanë marrë pushim nga puna.

Virologu Anxhela Ramusen nga Univbersiteti Saskaevan në Kanada numëron edhe disa nga arsyet për mos marrjen e vaksinës së dytë të Kovid: "Ekzistojnë disa njerëz të cilët ndoshta kanë lexuar spekulime se një dozë është e mjaftueshme, që mund t'ju shkaktoj ndjenjë të rrejshme të sigurisë". Arsye e dytë që mund të mos i trimërojë njerëzit që ta marrin dozën e tyre të dytë të vaksinës janë simptomat pas vaksinimit.

"Disa njerëz ndoshta nuk kanë pasur efekte të pa këndshme lidhur me dozën e parë dhe vetë kanë vendosur se nuk duan ta përjetojnë atë sërish me dozën e dytë", thotë ajo, duke shtuar se numër i vogël njerëzish ndoshta thjeshtë kanë harruar se duhet të marrin dozën e dytë të vaksinës kundër korona virusit. Vetëm në raste të rralla për shkaqe medicine këshillohet që të mos merret doza e dytë. Por, a është e mjaftueshme vetëm një dozë? Ekspertët akoma thonë – nuk është! Edhe pse studimet e para tregojnë se tanimë pas dozës së parë në përqindje të madhe zhvillohet imuniteti i virusit, megjithatë është e paqartë se sa ai zgjat.

Në dy studime të Entit britanik për statistikë dhe në Universitetin Oksford thuhet se pjesë e simptomave të infektimit me korona virusin zvogëlohet në dozën e dytë nga Biontek/Fajzer për 90 për qind, ndërkaq, për Astra Zeneka të dhënat akoma nuk janë të pranishme, nga se për dozën e dytë pritet 12 javë.

Koen Pauels, autor i studimit dhe kërkues në Pjesën Nafild për shëndet të popullatës të Universitetit Oksford, thotë se pranimi i dozës së dytë të vaksinës çon kah mbrojtja më e gjatë dhe më mbrojtës nga Kovid -19.

"Sikurse edhe në sëmundje të tjera ngjitëse, edhe me këtë rast, pas dozës së parë shkallë e lartë e mbrojtjes, por ai do të bjerë". Doza e dytë dukshëm e rrit nivelin e kundër trupave , sidomos tek më të vjetrit, prandaj është shumë me rëndësi që të merret edhe vaksina e dytë, ka thënë Pauels.

Kohë më parë për këtë çështje paralajmëroi edhe Majkl Vorner, mjek i ashtu thënë zonë e kuqe në spitalin e Torontos. Ai thotë se në respiratorë shpeshherë mbarojnë pacientë të cilat para më gjatë kohë kanë marrë dozën e parë, ndërkaq, nuk e kanë marrë të dytën.

Më ndryshe mund të jetë me njerëz të cilët kanë kaluar Kovid-19. Komisioni për vaksinim në Gjermani për momentin këtyre njerëzve u porosit, pas kalimit të infektimit me korona virus, të presin së paku 6 muaj, e pastaj të marrin vetëm një dozë.

"Për arsye të imunitetit të pranishëm pas kalimit të infeksionit, paraqitet përgjigje imuniteti më e mirë si rezultat i përforcimit me dozën e parë të vaksinës. Të gjitha Kovid-vaksinat e lejuara mund të shfrytëzohen për vaksinim të shëruarve", ka thënë Stiko. Në konkludim të njëjtë ka ardhur edhe studimi i qendrës medicinale Sidars-Sinaj, nga Los Angeles. Pas kontrollimit të 260 njerëzve të cilët ishin të infektuar me korona virusin, e mandej kanë pranuar vetëm një dozë nga vaksina Fajzer, është përfunduar se përgjigjja e imunitetit është i ngjashëm si tek njerëzit të cilët kishin pranuar të dy dozat.

Hulumtimet e kryera nga Instituti për Pen imunologjik, gjithashtu, ka zbuluar se njerëzit të cilët janë mëkëmbur nga infeksioni, kanë treguar përgjigje të fuqishme me kundër trupa pas dozës së parë të vaksinës. Në lajmërim për opinionin, imunologu dhe bashkë autori i studimit, E. Xhon Veri, thotë se "këto rezultate janë trimëruese si për efikasitetin e vaksinës afatshkurtër dhe të asaj afatgjate".